



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Thirrje e hapur për pjesëmarrje në trajnimin “Iniciativa e burrave të rinj” për mësimitdhënësit e shkollave të mesme

A jeni mësimitdhënës i shkollës së mesme në Kosovë?

Jeni të interesuar për përvijë të drejtpërdrejtë përmes trajnimit edukativ për të trajtuar pabarazitë gjinore, praktikat e dëmshme shëndetësore dhe për të parandaluar format e tjera të dhunës mes adoleshentëve?

Misioni i OSBE-së në Kosovë, në bashkëpunim me CARE International dhe organizatat vendore partnere Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmohatar (PEN) dhe Sinergija, mbështesin “Iniciativën e burrave të rinj” duke ofruar trajnim njëditor për mësimitdhënësit e shkollave të mesme (deri në 40 mësimitdhënës) në Kosovë. E akredituar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, “Nisma e Burrave të Rinj” është program mbarë rajonal i zhvilluar për të promovuar zgjedhje të shëndetshme të stilit jetësor për burrat dhe djemtë e rinj dhe për ti luftuar normat e ngurta sociale dhe gjinore.

Trajnimi është planifikuar të mbahet më 23 mars 2019, ditë e shtunë, ndërsa vendndodhja do të bëhet e ditur pasi që të përzgjidhet grupi.

Nëse jeni të interesuar të merrni pjesë, ju lutemi dërgoni biografinë tuaj dhe letrën e motivimit në adresën elektronike në vijim:

Faton.Ajeti@osce.org

Trajnimi është përgatitur për të fuqizuar kapacitetin e mësimitdhënësve të shkollave të mesme për të zhvilluar qëndrime dhe sjellje më të barabartë në raport me të rinjtë. Adoloshenca paraqet një cikël jetësor shumë të rëndësishëm në procesin e socializimit, kur qëndrimet dhe sjelljet janë në formësim e sipër. Trajnimi mëton ti përgatis mësimitdhënësit për adresimin e këtyre çështjeve me nxënësit e tyre, si pjesë e rregullt e kurrikulës shkollore. Prandaj, fuqizimi i burrave dhe djemve për të njohur dhe për të kundërshtuar me sukses normat e dëmshme sociale, duke përdor njohuritë dhe shkathtësitë e tyre, do të çojë në vendime efektive që do të kontribuojnë në zgjidhjen paqësore dhe të shëndetshme të problemeve që dalin nga raportet njerëzore dhe do të promovojnë një shoqëri me më shumë barazi dhe drejtësi.

Afati për aplikim: 5 mars 2019.